



## Komunikatë për Media

### Çfarë u tha në Raportin e Vendit për Kosovën: analizë dhe rekomandime mbi fushat kryesore

**Prishtinë, 6 nëntor 2025** - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka mbajtur sot konferencë për media ku ka shpalosur të gjeturat kryesore të Raportit për Vendin të përpiluar nga Komisioni Evropian për vitin 2024. Raporti i këtij viti vlerëson Kosovën në dy faza të ndryshme, sepse gjysma e tij vlerëson kohën me një qeveri me mandat të plotë dhe pjesën tjetër me një qeveri në detyrë dhe kompetenca të kufizuara.

Në vlerësim të përgjithshëm të *përgatitjes*, Kosova thuhet të ketë arritur përmirësim në 4 kapituj: Kapitullin 12 Siguria e ushqimit, Kapitullin 14 Politikat e transportit, Kapitullin 19 Politika sociale dhe punësim si dhe Kapitullin 30 Marrëdhëniet e jashtme. Megjithatë, ky lloj përparimi marginal nuk i përgjigjet nevojave për reforma të thella për integrim të shpejtë. Kjo sepse nëse konsiderohen të gjithë kapitujt për të cilët vendi ynë vlerësohet, Kosova ende mbetet **në nivel të njëfarë përgatitjeje**.

Kurse *sa i përket progresit*, raporti i këtij viti vlerëson se Kosova ka progres të limituar në 17 kapituj, në 11 njëfarë progresi, në 2 fare progres, dhe vetëm një kapitull (Kapitullin 19 Politika sociale dhe punësim) ka shënuar progres të mirë në 2025.

Thënë këtë, pasojat e ngrëçit politik vërehen në tërë raportin, dhe fjalët kryesore që karakterizojnë vlerësimin e këtij viti janë: **stagnim dhe progres i limituar**. Pra, edhe pse Kosova mbetet e përkushtuar në rrugën e saj Evropiane, realiteti politik i këtij viti ka pasur pasoja të mëdha dhe mund të konstatohet si një **vit i shkuar dëm**.

Sa i përket disa prej fushave kyçe që GLPS mbulon, Raporti konstaton si më poshtë:

#### Kriteret Politike

- Vlerësohet se zgjedhjet e 9 shkurtit kanë qenë **të lira dhe fer**, por kritikohet vonesa për themelimin e institucioneve pas zgjedhjeve. Theksohet vullneti për integrim evropian por ngecja politike ka shkaktuar stagnim në rrugën drejt BE-së.
- Kritikohet mungesa e vullnetit për ratifikimin e Marrëveshjeve të Facilitetit dhe Huasë për të përfituar nga **Plani i rritjes**. Po ashtu shkalla e zbatimit të reformave për Agjendën e reformave vlerësohet të jetë e pamjaftueshme.

#### Reforma në Administratë Publike

- Raporti i vitit 2025 ka theksuar që Kosova ka pasur progres të kufizuar në këtë fushë.
- Vlerësimi ka përsëritur qëndrimin e vitit të kaluar, ku thotë që Kosova duhet **të adresojë rekomandimet e BE-së lidhur me Ligjin për Zyrtarët Publik dhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese sa i përket Ligjit të Pagave në Sektorin Publik**. Në linjë me opinionin e GLPS-së, shqetësimet kryesore edhe pas plotësim-ndryshimit të Ligjit për Zyrtarët Publik, mbesin efektet e politizimit, kufizimet në avancimin në karrierë dhe stabilitetin e shërbimit civil.



Ndërsa te Ligji për Pagat, raporti thekson faktin që procesi i klasifikimit dhe sistematizimit të vendeve të punës nuk është finalizuar.

- Poashtu, Komisioni ka rekomanduar që të rriten kapacitet e shërbimit civil sa i përket rekrutimit të bazuar në meritë, vlerësimit të performancës dhe masave për barazi gjinore. Sa i përket rekrutimit të bazuar në meritë, GLPS përmes monitorimit aktiv të proceseve të rekrutimit, ka rekomanduar që të rriten kapacitet, të respektohen afatet në mënyrë që të sigurohet efikasiteti i procedurave dhe të krijohet banka e pyetjeve për testimin me shkrim. GLPS ka rekomanduar edhe përditësimin e Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për të siguruar më shumë fleksibilitet dhe mbështetje më efektive në zbatimin e procedurave të rekrutimit.
- Sikurse vitin e kaluar, në linjë edhe me reagimet e vazhdueshme të GLPS, raporti **sheh me shqetësim numrin e lartë të pozitave menaxheriale me ushtrues/e detyre**. Edhe sipas Raportit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të vitit 2024, vetëm në nivelin e lartë drejtues, 72% e pozitave mbahen me ushtrues detyre.
- Sa i përket **kornizës strategjike për administratën publike**, raporti konstaton që **zbatimi duhet përmirësuar**. Në të njëjtën kohë, koordinimi mes institucioneve kyçe dhe niveleve administrative mbetet sfidë.
- Lidhur me llogaridhënien, Komisioni vlerëson që është bërë **progres i kufizuar sa i përket racionalizimit dhe vendosjes së linjave të llogaridhënies për agjencitë e pavarura dhe ato ekzekutive**, duke theksuar faktin që numri i trupave në kuadër të Kuvendit duhet zvogëluar. Përmendet fakti që disa ligje janë miratuar pa konsultime të duhura publike dhe se gjithëpërfshirja në planifikimin dhe zbatimin e reformave është e pamjaftueshme.
- Megjithatë, në fushën e ofrimit të shërbimeve, Kosova vlerësohet që ka pasur **një progres në thjeshtimin e shërbimeve administrative** përmes miratimit të programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin të Barrës Administrative (2025-2028) dhe Planit të Veprimit (2025-2026).

#### Gjyqësori dhe të drejtat themelore

- Në këtë kapitull, Kosova vlerësohet të jetë **mes një “faze të hershme të përgatitjes” dhe “njëfarë përgatitje”** dhe ka bërë **progres të limituar** në vitin e fundit. BE vlerëson që ligjet dhe strategjitë në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave të njeriut janë në linjë me *acquis* dhe standardet evropiane, por ka mungesë të vullnetit për implementimin e tyre në tërësi.
- Raporti bën thirrje për **përsëritje të shpejtë** të procesit për **emërimin e Kryeprokurorit/es të Shtetit**, duke kritikuar kështu procesin e kaluar të përzgjedhjes së kësaj pozitë. GLPS e sheh këtë pozitë të rëndësishme shumë të madhe, dhe emërimi i shpejtë, i bazuar në parime të transparencës e meritokracisë është shumë i nevojshëm për funksionimin e drejtë të sistemit prokurorial.
- Poashtu, bëhet thirrje për implementimin efektiv të dispozitave të reja të Ligjit për KPK-në. GLPS vlerëson se vetëm implementimi i drejtë i ndryshimeve të reja ligjore mund të sjell llogaridhënie, efikasitet dhe transparencë brenda KPK-së. Raporti thekson edhe faktin se një numër i konsiderueshëm i ligjeve për reformat në drejtësi tashmë janë për vlerësim procedural ose material në Gjykatën Kushtetuese.
- Vlerësimi i sivjetëm vë në pah sulmet e vazhdueshme të qeverisë ndaj sistemit të drejtësisë dhe nevojën për përmirësimin e kësaj situate. GLPS në vazhdimësi ka konstatuar faktin se sulmet e tilla e çenojnë parimin e ndarjes së pushteteve dhe kanë ndikim direkt në pavarësinë e gjyqësorit dhe besimin e qytetarëve në institucionet ligjzbatuese.
- Raporti reflekton gjetjet e GLPS-së se ekzistojnë sfida sistemike në lidhje me trajtimin e krimeve të rënda dhe rasteve të dhunës me bazë gjinore, të lidhura veçanërisht me ndjekjen



penale joefikase, aktakuzat dhe vendimet gjyqësore të mangëta, si dhe mospërputhjen në praktikat e dënimit.

- Raporti vë në pah nevojën për koordinim dhe bashkëpunim të ndërsjelltë mes gjyqësorit, ekzekutivit dhe legjislativit për reforma në drejtësi. GLPS në vazhdimësi ka avokuar që bashkëpunimi ndërinstitucional mbetet kyç për ofrimin e një drejtësie efektive për të gjithë qytetarët.
- Theksohet, me të drejtë, mungesa e miratimit të **Kodit Civil** dhe **Kodit të Procedurës Civile**;
- BE ka vlerësuar pozitivisht progresin e vazhdueshëm të Prokurorisë Speciale në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të dhunës seksuale të kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë. Por, paraqet si sfidë mungesën e bashkëpunimit bilateral të Serbisë nga viti 2022.
- BE vë theksin edhe tek mungesa e bashkëpunimit ndërkombëtar juridik në fushën penale nga ana e Serbisë lidhur me kërkesat e Kosovës për ndihmë rreth hetimit të sulmit në Banjska dhe Kanalit të Ibër-Lepencit.
- Lufta kundër krimit të organizuar është konkretizuar me rritjen e numrit të aktakuzave por gjatë vitit 2024 nuk u shpall asnjë aktgjykim ndaj personave të përfshirë në këto raste.
- Raporti thekson mungesën e vendimeve përfundimtare në rastet e korrupsionit, kthimi i shpeshtë i rasteve në rigjykim, politika e ultë ndëshkimore dhe zvarritjen e rasteve në trajtim. Kurse, i vlerëson pozitive shqiptimin e dënimeve plotësuese për zyrtarët e shpallur fajtorë për vepra penale nga kapitulli i korrupsionit zyrtar.
- Sa i përket lirisë së shprehjes, raporti është dukshëm më negativ në krahasim me vitet e kaluara. Përmenden 70 raste sulmesh fizike dhe verbale, si dhe gjuha ofenduese gjatë fushatës zgjedhore, përfshirë nga zyrtarë të lartë dhe vetë kryeministri.
- Raporti kritikon mungesën e financimit afatgjatë për transmetuesin e vetëm publik – RTK-në, dhe zhvillimet negative në kuadër të Këshillit të Pavarur të Mediave (KPM). Sa i përket KPM-së, raporti thekson faktin se ligji u rrëzua nga Gjykata Kushtetuese sepse kishte dispozita të cilat çënonin seriozisht pavarësinë e këtij institucioni. Mbetet shumë e rëndësishme që ligji i ri të jetë në linjë të plotë me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare.

### Drejtësia, Liria, dhe Siguria

- BE-ja kritikoi procedimin pa konsultim publik dhe me procedurë të përshtetur të Ligjit për Byronë kurse vë theksin në funksionalizimin e Zyrës për Rikthimin e Aseteve në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.
- Raporti thekson suksesin e Policisë së Kosovës kundër grupeve kriminale dhe sekuestrimin e një sasive të konsiderueshme pasurish materiale, duke përfshirë para të gatshme, armë dhe municione.
- Rekrutimi i një numri të pjestarëve të komunitetit serb në Policinë e Kosovës shihet po ashtu pozitivisht.

### Normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë

- Ky raport njëjtë si vitet e kaluara i kushton rëndësi të veçantë **normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë**. Nga Kosova kërkohet themelimi i Asociacionit ndërsa nga Serbia njohja e simboleve të Kosovës. Raporti shpreh se ka pasur vazhdim të dialogut por se zbatimi i Marrëveshjes së Ohrit ka qenë i pamundur në mungesë të stabilitetit politik qoftë në Kosovë e qoftë në Serbi.
- Në raport përmenden veprimet në veri si ndërtimi i urës e arrestimet e Igor Popoviqit e disa zyrtarëve të sigurisë si mospërshtatje nga ana e Kosovës ndërsa lobimi kundër Kosovës në



arenën ndërkombëtare, arrestimi i Arbnor Spahiut dhe mosrespektimi i Marrëveshjes për ndihmë të ndërsjellë juridike nga Serbia si mospërshtatje e kësaj të fundit.

- Në raport përmendet në terma shumë të qartë se qasja në fondet e **Planit të rritjes** kushtëzohet nga përparimi në procesin e Dialogut me Serbinë. GLPS konsideron se Kosova është duke rrezikuar seriozisht përfitimin nga fondet e Planit të Rritjes së BE-së, fakt për të cilin [GLPS ka reaguar qysh në maj të këtij viti](#). Nga ky Plan është parashikuar që Kosova të përfitoj rreth 883 milion euro në total, ndërkaq në momentin e ratifikimit të Marrëveshjeve në Kuvend, Komisioni Evropian është zotuar të ekzekutojë një parapagesë prej 7% të kësaj shume (rreth 61.8 mil Euro). Fatkeqësisht, si pasojë e krizës politike, Kuvendi nuk ka arritur t'i ratifikojë ato, përderisa shtetet e rajonit tashmë kanë filluar të pranojnë këstet e dyta në kuadër të këtij Plani.
- **Heqja e masave** kushtëzohet me transferimin paqësor të pushtetit në komunat veriore, pas zgjedhjeve të raundit të dytë që do të mbahet në 9 nëntor.
- Sa i përket normalizimit të marrëdhënieve, shihet qartazi një gjuhë më e balancuar nga ndërmjetësuesit e BE-së. Duke konsideruar këtë fakt dhe përbërjen e re në Komisionin Evropian, mbetet shumë e rëndësishme që partitë politike të gjejnë një zgjidhje sa më të shpejtë për dajlen nga ky bllokim politik. Duke qenë se të hyrat nga Plani i Rritjes lidhen drejtpërsëdrejti me suksesin në Dialog, koordinimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me BE-në dhe mekanizmat e tjerë ndërkombëtar në këtë drejtim, mbetet thelbësor.

Sinqerisht,  
Grupi për Studime Juridike dhe Politike